




Pranuar / Dorezuar Punë/Prodate Received/Delivory	28	12	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKPM/SHK/	6375	2021	119		



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.931/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.931/2021 të datës 12.11.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati Hajzer Salihu me adresë Rr."Fehmi Agani", Hyrja 154, Kati I, Nr.8, Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.1074 të datës 18.10.2021 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "*transferim i përkohshëm*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 28.12.2021, mori këtë

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.931/2021 e datës 12.11.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.1074 i datës 18.10.2021 i Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të njëjtë, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës sipas Aktit të Emërimit të datës 03.12.2013, dhe duke ia kompensuar diferencën e pagës nga pozita ku është transferuar, dhe shpenzimet tjera të shkaktuara nga ky transferim, nga data 18.10.2021 deri në zbatim të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, me datë 12.11.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 5429/2021 të regjistruar me numër A.nr.931/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.1074 të datës 18.10.2021 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të shkeljeve materiale dhe procedurale me rastin e transferimit të përkohshëm nga pozita e Drejtorit të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim në Ministrinë e Punëve të Brendshme në pozitën Zyrtar i Lartë Ekzekutiv në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.11.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli më datë 24.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 5429/2021 të regjistruar me numër A.nr.931/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 12.11.2021; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 02.12.2013; Vendimin me Nr. Prot:74 të datës 15.04.2021 për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil; Emailin e datës 15.10.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 14.10.2021 dhe 30.03.2021 nga V.B; Vendimin me Nr.1074 të datës 18.10.2021 për transferimin e përkohshëm; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.11.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 24.11.2021; Kërkesën për transferim, të datës 30.03.2021; Emailin e datës 18.10.2021 nga Xh.K për V.B; Emailin e datës 07.04.2021 dhe 30.03.2021 nga V.B për A.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit me numër protokoll 779 të datës 02.12.2013 është konstatuar se ankuesi është i punësuar me afat të pacaktuar në pozitën e punës "Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim" në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, me datë 15.04.2021 ka nxjerr Vendimin Nr.prot:74 për transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita e punës "Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim" në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë Ekzekutiv" në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. Sipas këtij vendimi, transferimi i ankuesit është bërë për një periudhë gjashtë (6) mujore, respektivisht nga data 15.04.2011 deri më datë 14.10.2021.

Ankuesi, përmes emailit të datës 15.10.2021 ka njoftuar Menaxheren e Burimeve Njerëzore në MPB, lidhur me përfundimin e periudhës së transferimit të përkohshëm dhe njëkohësisht ka kërkuar nga e njëjta që t'i ndër marr veprimet e nevojshme për përfshirjen e tij në listën e pagave sipas akt emërimit në fuqi.



Menaxherja e Burimeve Njerëzore pranë MPB-së, duke u bazuar në dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me datë 18.10.2021, ka nxjerr Vendimin Nr.1074, përmes të cilit ankuesi për interes të institucionit, përsëri është transferuar nga pozita e punës "Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim" në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë Ekzekutiv" në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

I pakënaqur me Vendimin Nr.1074 të datës 18.10.2021 për transferim të përkohshëm në interes të institucionit, ankuesi me datë 12.11.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi për transferimin e tij është nxjerr përmes shkeljeve ligjore, materiale dhe procedurale, andaj mbi bazën e shkeljeve të pretenduara, ankuesi kërkon që: Të aprovet ankesa si e bazuar, të anulohet Vendimi Nr.1074 i datës 18.10.2021 për transferim të përkohshëm dhe i njëjti të kthehet në pozita e punës "Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim" në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës sipas Akt Emërimit me numër protokolli 779 të datës 02.12.2013. Po ashtu, ankuesi kërkon nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të obligoj organin e punësimit, gjegjësisht Ministrin e Punëve të Brendshme që ankuesit t'ia kompensoje diferencën e pagës për koeficient shtesë në shume prej 121.16 euro, bruto, dhe shpenzimet e udhëtimit të shkaktuar sipas Vendimit Nr.74 të datës 15.04.2021, për përudhen nga data 15.04.2021 deri në zbatimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 52 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Vendimi Nr.1074 i datës 18.10.2021 për transferimin e përkohshëm të ankuesit, për interes të institucionit, nga pozita e nivelit të mesëm drejtues, gjegjësisht pozita e Drejtorit të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, në pozitën e punës Zyrtar i Lartë Ekzekutiv në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, sepse ankuesi në rastin konkret është transferuar në kategori me të ulët funksionale, gjegjësisht nga pozita e kategorisë së mesme drejtuese, në pozitë të kategorisë profesionale, në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Kolegji, vlerëson se Vendimi Nr.1074 i datës 18.10.2021 për transferimin e ankuesit është në kundërshtim edhe me paragrafin 6 të nenit 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi edhe me herët ka qenë i transferuar në të njëjtën pozitë të punës, nga data 15.04.2011 deri më datë 14.10.2021, kështu që me përfundimin e kësaj periudhë të transferimit organi i punësimit është dashur të nxjerr vendim për kthimin e te



njëjtë në pozitën paraprake, dhe jo t'i vazhdoje transferimin siç ka vepruar në rastin konkret, andaj pretendimi ankimor i ankuesit në kuptim të shkeljes së ligjit material është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu ka konstatuar se Vendimi Nr.1074 i datës 18.10.2021 për transferimin e ankuesit, i nxjerr nga Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, është në kundërshtim edhe dispozitat procedurale, për faktin se i njëjti në pjesën urdhëruese nuk përmban afatin apo periudhën e transferimit, me çka ankuesi do ta kuptonte kohën e qëndrimit në pozitën e transferuar, andaj si i tillë vendimi është në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në konstatimet si me lartë, kolegji vlerësojë se Vendimi Nr.1074 i datës 18.10.2021 për transferimin e ankuesit është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbi Këqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të aprovoje pjesërisht ankesën e ankuesit dhe të anulonte vendimin e kontestuar, si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ndërsa, pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës dhe shpenzimet e udhëtimit për periudhën kohore 15.04.2021 - 15.10.2021, periudhe kjo kur ankuesi ka qenë i transferuar sipas Vendimit me Nr.74 të datës 15.04.2021, refuzohet si i pa bazuar, sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.931/2021

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës



Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB);
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

